

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit komunal të komunës Preshevë për shpalljen e Konkursit public për pjesëmarrjen e familjeve me zbatimin e masës së sanimit energjetik të instalimit të paneleve solare për prodhimin e energjisë elektrike për nevojat e tyre dhe avansimin e sistemit termoteknik nëpërmjet instalimit të kalorimetrave, pompave të qarkullimit, valvulave termostatike dhe ndarësit e nxehtësisë nr.III.nr.404-65 të dates 11.05.2023 dhe Rregullores mbi sufinansimin e sanimit energjetik të shtëpive dhe banesave familjare përmes instalimit të paneleve solare për prodhimin e energjisë elektrike për nevojat vetanake dhe avansimin e sistemit termoteknik nëpërmes instalimit të kalorimetrae, pompave qarkulluese, valvulave termostatike dhe ndarësit e nxehtësisë në bazë të thirrjes publike për sufinansimin e programit të sanimit energjetik të objekteve të banimit, shtëpive dhe banesave familjare THP/22 nr.: III.312-18 prej 06.05.2022 (në tekstin vijues: Rregullore),

shpall

KONKURS PUBLIK

Për sufinansimin e ndërtimit e instalimit të paneleve solare për prodhimin e energjisë elektrike në shtëpitë familjare dhe avansimin e sistemit termoteknik përmes vendosjes së kalorimetrave, pompave qarkulluese valvulave termostatike dhe ndarësve të nxehtësisë në teritorin e Komunës Preshevë për vitin 2022

I. LËNDA

Lënda e finansimit përfshinë si vijon:

- 1) furnizimin dhe instalimin e paneleve solare, inverterëve dhe instalimeve përcjellëse për shtëpitë familjare për prodhimin e energjisë elektrike për nevojat vetanake, instalimi I një paisjeje matëse të dyanshme për matjen e energjisë elektrike të dorëzuar dhe marrë dhe përgaditja e dokumentacionit teknik të nevojshëm dhe raportit të kryer si të punëve në instalimin e paneleve solare dhe instalimeve përcjellëse për prodhimin e energjisë elektrike të cilat janë në pajtim me Ligjin të domosdoshme gjatë kyçjes në sistemin distributiv. Fuqia e paneleve solare nuk mund të jetë më e madhe se fuqia e miratuar e pikës matëse, e cila është e specifikuar në faturën për energjin elektrike të harxhuar, **e maksimumi deri dhe e barabarë me 6kw dhe** instalimet tjera të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike dhe kyçjen në sistemin distributive në pajtim me Aneksin 4 nga Thirrja publike.
- 2) Instalimi I pompave të rregulluara elektronikisht për **shtëpitë familjare**, pompat;

Amvisrit (për shtëpitë familjare dhe banesat) nuk mund të konkurojnë për më shumë se një masë të efikasitetit energjetik nga ky seksion.

Mjetet e tërsishme të cilat komuna së bashku me mjetet e drejtorisë për nxitjen dhe avansimin e efikasitetit energjetik të Republikës së Serbisë, ndan përmes këtij Konkursi për masat nga neni 1 paragr.1 pika 1) e Thirrjes publike 700.000,00 dinarë, për masat nga neni 1 paragr.1 pika 2 dhe 3), e Thirrjes publike 100.000,00 dinarë.

SHFRYTËZUESIT E MJETEVE

Shfrytëzuesit e mjeteve të pakthyeshme janë amvisrit, në përjashtim të:

- 1) pronarët e pjesëve të veçanta të objekteve banesore-afariste, që nuk përdoren për banim;
- 2) pronarët e objekteve banesore të cilët në dy vitet e mëparshme pas dorëzimit të Aktvendimit për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme për aktivitete të ngjajshme, hoqën dorë nga zbatimi I aktivitetit.

III KUSHTET E APLIKIMIT NË KONKURS

Të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs kanë amvisrit që I plotësojnë kushtet si vijon:

- 1) të jetë paraqitësi I kërkesës,
 - (1) pronari I objektit për të cilin paraqet kërkesë dhe se aplikuesi është pronar ose bartës I të drejtave mbi njëhisorin, ose
 - (2) nëse paraqitësi I kërkesës nuk është pronar I objektit për të cilin ka paraqitë kërkesë, është e nevojshme që ai të ketë leje qëndrimi në adresën e objektit për të cilin paraqet kërkesë dhe me kërkesë të paraqet një pëlqim me shkrim të pronarit të objektit të vërtetuar nga ana e noterit që për objektin mund të dorëzohet aplikimi;
- 2) se është I kyçur në rrjetin distributive të energjisë elektrike dhe se në faturën e fundit për kërkesën e energjisë elektrike është regjistruar harxhimi prej së paku 30 kW; nëse ka më shumë se një pronar të shtëpisë familjare, është e nevojshme të paraqesin pëlqimin e pronarëve të tjerë gjatë aplikimit.

Nëse paraqitësi I kërkesës nuk është pronar I shtëpisë familjare, është e duhur të dërgohet pëlqimi I pronarit.

IV LARTËSIA MAKSIMALE E MJETEVE PËR SUFINANSIM

Shuma maksimale e mjeteve nxitëse, të cilat ndahen:

- 1) për masën nga neni 1 pika 1) e cila ka të bëjë me furnizimin dhe instalimin e paneleve solare, paraqet një shumë më të vogël se:
 - 50% e vlerës së investimit të përgjithshëm me TVSH, dhe maksimumi 420.000 dinarë me TVSH, dhe
 - shuma e fituar duke shumëzuar fuqin në kW të paneleve solare nga dorëzimi I profaturave me shumën prej 70.000 dinarë me TVSH;
- 2) për masën nga neni 1 pika 2) e cila mbështetet në instalimin e pompave qarkulluese të rregulluara elektronikisht, 50% nga shuma e parafaturës për punët dhe paisjet me TVSH dhe maksimumi 15.000 dinarë me TVSH për pompën qarkulluese.

V SHPENZIMET E PAPRANUESHME

Në shpenzimet e papranueshme biejnë:

- refondimi I shpenzimeve për paisjet dhe shërbimet e kryera tashmë të furnizuara (të paguara ose të porositura) gjegjësisht, nuk pranohen shpenzimet e punës, prokurimi I materialeve dhe paisjeve që bëhen para vizitës së parë të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për sufinansimin e projekteve të efikasitetit energjetik;
- shpenzimet lidhur me miratimin dhe zbatimin e kredis: shpenzimet e miratimit të kredis, shpenzimet e interest, shpenzimet e zyres së kredis, shpenzimet e sigurimit të kredis;
- prokurimi I paisjeve të cilin paraqitësi I kërkesës për mjetet e pakthyeshme I prodhon vetë ose për shërbimet që paraqitësi I kërkesës I kryen vetë;
- shpenzimet tjera që nuk janë në pajtim me masat e sanimit energjetik.

VI DOKUMENTACIONI I OBLIGUAR PËR APLIKIM NË THIRRJE PUBLIKE

Aplikacioni duhet të përmbajë:

- 1) formulari I palikimit I nënshkruar dhe plotësuar (shtojca 1) për sufinansimin e masave për efikasitetin energjetik;
- 2) një nga dëshmit vijuese për objektin banesor:
 - dëshmin mbi ndërtimin e objektit para miratimit të Rregullores së ndërtimit,
 - leja e ndërtimit e marrë me procedurë të rregullt të marrjes së lejes,
 - leja e ndërtimit e marrë nga procedura e legalizimit,
 - aktvendimi për legalizim ose dëshmi se ka filluar procedura e legalizimit.
- 3) Fotokopja e lejes së njohtimit ose leja e njohtimit e skanuar e paraqitësit të kërkesës dhe të personave që jetojnë në adresën e shtëpise familjare për të cilën është paraqitur kërkesa. Për të miturit dorëzohet fotokopja e librezës së shëndetsisë.
- 4) Paralogaria (profatura) me sasin dhe çmimin e paisjeve, të shënuara në nenin 1 të ftesës publike, me instalimin të cilën qytetari e merr nga njëri nga subjektët afarist (kryerësi I puëve) nga lista (shtojca 2), të shpallura nga Komuna të cilin qytetari e zgjedh nga lista;
- 5) Fotokopja e faturës për energjin e harxhuar elektrike për objektin banesor për të cilin aplikon për një nga muajt e mëparshëm;
- 6) Nëse paraqitësi I kërkesës nuk është pronar I shtëpis familjare është e nevojshme të dorëzon pëlqimin e pronarit (shtojca9);
- 7) Nëse në shtëpin familjare ka më shumë se një njëhsor, atëher kërkohet pëlqimi I të gjithë personave që janë pronar të njëhsorëve të tjerë.;
- 8) Deklarata se Komuna mund të merr certifikatën e pronësis për qytetarin nga kadastrin (shtojca 8).

VII MARRJA E DOKUMENTACIONIT PËR THIRRJEN PUBLIKE

Dokumentacioni I konkursit për Thirrjen publike mund të merret në faqen e internetit të Komunës Preshevë, ose në shkresoren e komunës dhe përbanë:

- 1) Tekstin komplet të Thirrjes publike,
- 2) Shtojcën 1 – për qytetarët- formularin e aplikimit dhe formularin mbi gjendjen familjare,

- 3) Shtojca 2- lista e firmave/ subjekteve ekonomike nga të cilat qytetarët zgjedhin një firmë nga e cila duhet të marrin një vlerësim dhe çmimin dhe sasin e paisjeve dhe instalimeve.
- 4) Shtojca 3- kriteret për zgjedhjen e projeteve,
- 5) Shtojca 4- kushtet e përgjithshme për kyçjen e moduleve fotovoltaike me instalimet e mbrendshme të objektit ekzistues të klientit për:
Amvisrit individuale me matje direkte;
Lëshuar nga ana e elektrodistribucionit të Serbisë SHPK Beograd 03.12.2021.
- 6) Shtojca 5- broshura e Ministrisë së minierave dhe energjetikës “hap pas hapi- si të bëheni klient – prodhues të energjisë elektrike”,
- 7) Shtojca 6 – kopia e faturës së energjisë elektrike me fuqi të shënuar të lejuar,
- 8) Shtojca 7 – modeli I kontratës për furnizimin e plotë me matje neto,
- 9) Shtojca 8 – deklarata se komuna mund të merr një certifikat pronësie për një qytetar nga kadastra,
- 10) Shtojca 9: deklarata e pëlqimit të pronarit.

VIII VENDI DHE AFATET PËR DORËZIM TË KËRKESAVE

Afati për paraqitjen e kërkesës është **21** nga dita e shpalljes ne faqen zyrtare dhe tabelën e shpalljeve të komunës Preshevë.

Konkursi është i hapur deri më 15.06.2023.

Formulari i plotësuar, i nënshkruar dhe i printuar në tri kopie, (një original dhe dy kopie) dhe dokumentacioni përcjellës dorëzohen në një zarf të mbyllur me shënimin:

**„PARAQITJA PËR THIRRJEN PUBLIKE PËR PJESËMARRJE TË QYTETARËVE
NË ZBATIMIN E MASAVE TË SANIMIT ENERGJETIK PËRMES INSTALIMIT TË
PANELEVE SOLARE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE – TË MOS
HAPET”** me adresën e plotë në anën e pasme të dërguesit:

Aplikimi dorëzohet personalisht në shkresoren e Administratës komunale të komunës Preshevë ose me postë rekomande në adresën:

Komuna e Preshevës, rruga Marshal Tito 36.

Komisioni për realizimin e masave të sanimit të energjetikës të Komunës Preshevë.

Për të gjitha informatat dhe njoftimet shtesë lidhur me Thirrjen publike mund të kontaktoni në numrin e telef. 0638587641 dhe adresën elektronike e-mail: a.isahu@presevo.rs

Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në ëeb. faqen e internetit të Komunës Preshevë.

Dorëzimi në kohë konsiderohet një dërges e regjistruar e dorëzuar në zyren postare deri në skadimin e ditës së fundit të afatit të caktuar për dorëzimin e dokumentacionit të Konkursit (vula postale), pamvarsisht nga data e mbërritjes.

Aplikimet e dërguara mnë ndonjë mënyrë tjetër nuk do të merren në shqyrtim.

Aplikimet e vonuara dhe jot ë plota nuk do të merren në shqyrtim.

IX KRITERET PËR ZGJEDHJEN E PROJEKTEVE

Kriteret për zgjedhjen e projekteve janë:

- 1) Gjendja ekzistuese e mureve të jashtme,
- 2) Mënyra primare e ngrohjes,
- 3) Karakteristikat ekzistuese të zdrukthtarisë së jashtme,
- 4) K factor I zënjes së sipërfaqes për shtëpi familjare,
- 5) Shfrytëzimi I subvencioneve për sanimin e energjisë (mjetet e komunës/Republikës).

Mënyra e detajuar e pikësimit sipas kriterëve të përmendura është dhënë në shtojcën 3

X VLERËSIMI, PËRCAKTIMI I LISTËS DHE ZGJEDHJA E SHFRYTËZUESVE PËRFUNDIMTARË

Vlerësimi dhe rangimi I projeteve të qytetarëve, bëhet në pajtim me Rregulloren me zbatimin e kriterëve nga seksioni IX I thirrjes publike.

Aplikimi do të konsiderohet I parregullt nëse ndonjë document nga seksioni VI të thirrjes publike mungon në formularin e dorëzuar me shkrim dhe në atë rast Aktvendimi do të refuzohet.

Aplikacioni me dokumentacion, përmbajtja e të cilës nuk është në pajtim me thirrjen publike nuk vlerësohet dhe Aktvendimi do të refuzohet.

Komisioni shqyrton aplikimet dhe në pajtim me kushtet nga seksioni III I thirrjes publike përcakton një listë të posaçme paraprake të renditjes së shfrytëzuesve për masën nga seksioni 1 paragr.1 pika 1) I thirrjes publike, ndërsa veçmas përmasat nga seksioni 1 al.1 pika 2 dhe 3 I thirrjes publike në bazë të pikave sipas kriterëve nga seksioni IX i thirrjes publike.

Gjatë procedurës së vlerësimit dhe zgjedhjes së projekteve Komisioni mund të kërkoj dokumentacion dhe informacion shtesë nga aplikuesi, sipas nevojës.

Lista nga paragr.4 i këtij seksioni, Komisioni shpall listën në tabelën e shpalljeve të komunës/qytetit dhe në faqen zyrtare të internetit të komunës/qytetit.

Paraqitësit e kërkesës kanë të drejtë të inspektojnë aplikacionet e dorëzuara dhe dokumentacionin e bashkangjitur me përcaktimin e listës nga paragr.4 I këtij neni në afat prej 3 ditësh nga dita e shpalljes së listës.

Në listën nga paragr.4 I këtij seksioni paraqitësit e kërkesës kanë të drejtë në kundërshtim Komisionit në afat prej 8 ditësh nga dita e shpalljes së saj. Kundërshtimi paraqitet në shkresoren NJVL.

Komisioni është I obliguar të shqyrtoj kundërshtimet e paraqitura për listat në paragr.4 të këtij neni, si dhe të merr vendim për kundërshtimin, I cili duhet të arsyetohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të saj dhe në bazë të vendimeve të marrura të bjen listën paraprake të rishikuar.

Në bazë të listës nga paragr.9 I këtij seksioni, komisioni kryen një vizitë në teren për të kontrolluar gjendjen e objekteve banesore, nga ato lista duke përfshirë numrin rendor të paraqitësve të kërkesës deri në të cilën sigurohen mjete totale për subvencionim.

Nëse komisioni gjatë vizitës në teren nga paragr.4 I këtij neni ka konstatuar se paraqitësi I kërkesës ka dhënë informacione jo të sakta në aplikim, Komisioni e eleminon atë nga lista paraprake e rishikuar dhe në vend të kësaj kryen një vizitë në teren tek personi tjetër në listë për të cilën nuk janë siguruar mjetet në bazë të listës paraprake.

Gjatë vizitës në teren me praninë e obligueshme të aplikantit, Komisioni përpilon procesverbalin në dy kopje me ç'rast njera i mbetet paraqitësit të kërkesës ndërsa tjera i mbetet Komisionit.

Në bazë të procesverbalit nga paragr.12 I këtij neni Komisioni përpilon listat përfundimtare të shfrytëzuesve.

Listat nga paragr.13 këtij neni Komisioni i shpall në tabelën e shpalljeve të komunës dhe në ëeb faqen e internetit të komunës.

Në listat e përmendura në paragr.13 të këtij neni paraqitësi i kërkesës të cilin është bërë një vizitë në teren, kanë të drejtë në kundërshtim komisioni në afat prej 8 ditësh nga dita e shpalljes së listës përfundimtare të shfrytëzuesve. Kundërshtimi paraqitet në shkresoren e komunës/qytetit.

Komisioni është i obliguar të vendosë për kundërshtimet nga paragr.15 këtij neni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kundërshtimit dhe pas vendosjes për të gjitha kundërshtimet të përpiloh listën përfundimtare të shfrytëzuesve përfundimtar.

Këshilli komunal i komunës/qytetit miraton Aktvenimin për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme qytetarëve për zbatimin e masave të sanimit të energjisë.

X MËNYRA E REALIZIMIT TË NDARJES SË MJETEVE

Komuna e Preshevës do të bënë transferin e mjeteve ekskluzivisht për subjektet afariste- kryerësit e punëve, e jo për amvistrin ose bashkësit banesore, pasi që qytetari të ketë kryer të gjithë pagesën ndaj kryerësit të punëve dhe pasi të ketë përfunduar realizimin e masave.

Kushtet për transferimin e mjeteve kryerësit e punëve është konfirmim i komisionit se punimet janë kryer siq parashikohet në vlerësimin e paramatjes dhe parafaturimit të cilën qytetari e ka dorëzuar kur ka aplikuar për masa si dhe në pajtim me procesverbalin e Komisionit me rastin e daljes së parë.

Qytetari duhet të ketë dokumentacionin e rregullt (llogarit dhe vërtetimet) që do të dorëzoj Komisionit kompetent.

Komuna e Preshevës do të bëjë bartjen e mjeteve kryerësve të punëve të zgjedhur në pajtim me kontratat e nënshkruara.

Kontrollimin e obligimeve të kontraktuara të ekzekutimit do të kryen organi kompetent që është i obliguar për urbanizëm, gjegjësisht mbrojtjen e mjedisit jetësor në bashkëpunim me Komisionin.

Nëse qytetari nuk i ka shpenzuar mjetet me dedikim, apo punët nuk janë kryer në pajtim me paramatjen dhe parallogarin që qytetari e ka paraqitur gjatë aplikimit, Komuna e Preshevës nuk do të paguaj mjetet e ndara përmes thirrjes publike.

Nëse për ndonjë arsye qytetari nuk arrin të realizoj furnizimin nga kryerësi i punëve i përzgjedhur, ka të drejtë të bëjë furnizim nga tjetri nga lista dhe për atë, para realizimit të furnizimit ta njohton komisionin dhe të dërgon faturën e re / parallogarin, me kusht që shuma të mos jetë më e lartë se ajo e miratuar.

Pjesë përbërse e Kontratës për masën e instalimit të paneleve solare është raporti teknik/ elaborate i lëshuar nga subjekti afarist i përzgjedhur (kryerësi i punëve) që përmban skemën dhe përshkrimin teknik të instalimit të panelës solare, si dhe deklaratën se në kulmin ekzistues mund të vendoset paneli solar dhe se në instalimin e mbrendshëm mund të instalohet me panel diellor. Raporti/ elaborate duhet të përmbajë të gjithë elementet e nevojshme për nxjerrjen e aktit mbi kycjen nga ana e ODS.

Pas kryerjes së punëve për masën e instalimit të paneleve solare qytetari duhet të paraqes para komisionit, dëshmin e pagesës së të gjithë pjesës së finansimit të punimeve për

instalimin e panelit solar dhe instalimeve tjera të subjektit afarist (kryerësit të punëve) (fletëpagesa / llogaria).

Kushtet që komuna ti bartë mjetet e subvencionit subjektit ekonomik (kryerësit të punëve) për masën e instalimit të panelit solar:

1. Vërtetimi I Komisionit se punët janë kryer si që është paraparë me paramasën dhe parallogarin të cilën qytetari e ka dorëzuar kur ka aplikuar në thirrjen publike.
2. Se qytetari ka nënshkruar Kontratën e furnizimit të plotë me neto matjen me EES me furnizim.
3. ODS lëshon aktin mbi kyçjen, kyç blerësin- prodhuesin në sistemin distributiv dhe e regjistron në regjistrin blerës-prodhues.

Nëse subjekti ekonomik nuk I shpenzuar mjetet me qëllim, ose nuk janë kryer punët në pajtim me parallogarin të cilën e ka paraqitë qytetari me rastin e aplikimit, komuna e Preshevës nuk do ti paguaj mjetet e ndara me Thirrje publike.

Kontrollin e kryerjes së obligimeve të kontraktuara do ti kryej Komisioni.

Nëse për ndonjë arsye qytetari nuk mund të bëjë prokurimin nga subjekti afarist I përzgjedhur, ai ka të drejtë të bëjë prokurimin nga një tjetër nga lista dhe të njohtoj Komisionin për këtë para se të bëhet prokurimi dhe të paraqes një profaktur / prologari të re, ashtu që shuma e subvencionit nuk mund të jetë më e madhe se shuma e lejuar.